RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji "Për Donacionet dhe Sponsorizimet"
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Administratës Publike Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm, në zbatim të Objektivit Specifik 1.2 të SNKK 2024-2030
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme; në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe OECD
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, Plani i Veprimit 2024-2026, Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	11/02/2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	10/11/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? **NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT**	Po 10/03/2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MAP/MTKS – Nr. 2 VN
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)

Në Shqipëri mungon aktualisht një kuadër ligjor i posaçëm, i unifikuar dhe gjithëpërfshirës për rregullimin e donacioneve dhe sponsorizimeve me interes publik. Kuadri ekzistues vetëm mbi sponsorizimet mbështetet kryesisht në dispozita të shpërndara në legjislacionin tatimor dhe sektorial, ndërsa për donacionet mungon një rregullim i dedikuar ligjor. Si pasojë, nuk ekziston një sistem i centralizuar dhe i detyrueshëm për regjistrimin, raportimin dhe monitorimin e këtyre marrëdhënieve financiare midis sektorit publik dhe privat.

Mungesa e standardeve të unifikuara për transparencën, deklarimin dhe kontrollin e donacioneve dhe sponsorizimeve ka krijuar boshllëqe në gjurmueshmërinë e fondeve, në verifikimin e burimit dhe përdorimit të tyre, si dhe në parandalimin e konfliktit të interesit dhe ndikimeve të papërshtatshme në vendimmarrjen publike. Kjo situatë krijon gjithashtu pasiguri juridike për institucionet publike, subjektet private dhe organizatat përfituese, si dhe ndikon negativisht në besimin publik ndaj administrimit të fondeve për veprimtari me interes publik.

Ky boshllëk ligjor është evidentuar edhe në kuadër të prioriteteve kombëtare për forcimin e integritetit institucional dhe transparencës financiare, në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, që adresojnë standardet dhe praktikat e promovuara nga Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës dhe OECD.

Mungesa e rregullimit prek drejtpërdrejt institucionet publike dhe autoritetet mbikëqyrëse pranë tyre, të cilat nuk disponojnë mekanizma të unifikuar për regjistrimin dhe kontrollin e donacioneve dhe sponsorizimeve. Po ashtu, subjektet private dhe sponsorizuesit, të cilët operojnë në një mjedis me rregulla të fragmentuara dhe praktika jo të standardizuara apo edhe organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera përfituese, të cilat nuk kanë standarde të harmonizuara transparence dhe raportimi. Në mënyrë të tërthortë, problematika ndikon edhe tek qytetarët dhe publiku, duke cenuar besimin në integritetin e proceseve vendimmarrëse dhe administrimin e fondeve me interes publik.

Në këtë kontekst, ndërhyrja e qeverisë vlerësohet e domosdoshme për krijimin e një kuadri të qartë, të detyrueshëm dhe të unifikuar ligjor për donacionet dhe sponsorizimet, me qëllim forcimin e transparencës, integritetit institucional dhe mekanizmave të kontrollit dhe llogaridhënies.

Qëllimi i nismës është të forcojë transparencën, gjurmueshmërinë dhe kontrollin e donacioneve dhe sponsorizimeve për veprimtari me interes publik. Të gjitha sponsorizimet, pavarësisht vlerës, regjistrohen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve, që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Organet publike evidentojnë donacionet që pranojnë dhe publikojnë informacion për secilin prej tyre në Programin e Transparencës.

Gjatë procesit të vlerësimit për pregatitjen e këtij kuadri ligjor janë shqyrtuar katër opsione politikash: (0) ruajtja e *status quo*-së, (1) ndërhyrje të pjesshme në legjislacionin ekzistues, (2) miratimi i një ligji të ri "Për Donacionet dhe Sponsorizimet" dhe, (3) masa jorregullatore përmes udhëzimeve administrative dhe instrumenteve vetërregulluese.

Analiza krahasuese tregon se opsioni i *status quo*-së dhe ndërhyrjet e pjesshme nuk adresojnë në mënyrë efektive boshllëqet ekzistuese në transparencë, gjurmueshmëri dhe kontroll institucional. Opsioni jorregullator, ndonëse me kosto më të ulëta administrative, nuk krijon detyrime ligjore dhe mekanizma të qëndrueshëm mbikëqyrës. Për këtë arsye, opsioni i preferuar mbeti Opsioni 2: miratimi i një ligji të ri, të posaçëm "Për Donacionet dhe Sponsorizimet", i cili ofron zgjidhjen më të plotë, të qëndrueshme dhe koherente për adresimin e problematikës së identifikuar.

Miratimi i ligjit pritet të ketë ndikime pozitive afatmesme dhe afatgjata në rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së fondeve, forcimin e kontrollit financiar dhe fiskal, reduktimin e risqeve të konfliktit të interesit dhe ndikimeve të papërshtatshme, si dhe në rritjen e besimit publik ndaj administrimit të fondeve për veprimtari me interes publik.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)
Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet miratimit të kësaj politike janë:

Nisma synon të rrisë transparencën dhe gjurmueshmërinë e mbështetjes për veprimtaritë me interes publik. Sponsorizimet regjistrohen, pavarësisht vlerës, në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve, që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Donacionet evidentohen nga organi publik përfitues, i cili publikon informacion për çdo donacion të pranuar në Programin e Transparencës. Këto mekanizma mbështesin verifikimin e burimit dhe të përdorimit të mbështetjes së përfituar. Kjo ndërhyrje synon harmonizimin e kuadrit kombëtar me standardet e

Këshillit të Evropës, OECD-së dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian.

Nisma adreson drejtpërdrejt shkaqet e identifikuara të problemit, përfshirë mungesën e një rregullimi të posaçëm dhe të detajuar ligjor për donacionet dhe sponsorizimet, mungesën e transparencës në dhënien, pranimin dhe përdorimin e tyre, si dhe mungesën e mekanizmave të qëndrueshëm të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies për aktorët publikë dhe privatë të përfshirë.

Objektivat specifikë të propozimit janë:

1. Vënia në funksion e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe e shërbimit elektronik përkatës brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Objektivi i përputhshmërisë është regjistrimi i të gjitha sponsorizimeve, pavarësisht vlerës, brenda afatit ligjor. Gjatë periudhës kalimtare, përmbushja e detyrimit matet mbi bazën e deklarimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
2. Publikimi nga organet publike i informacionit për të gjitha donacionet e pranuara, pavarësisht vlerës, si dhe publikimi i kontratave dhe raporteve të sponsorizimit dhe i dokumenteve për donacionet financiare, sipas rasteve dhe afateve të përcaktuara në nenet 21 dhe 24.
3. Matja veçmas e numrit dhe vlerës së sponsorizimeve, sipas kategorive të përfituesve dhe fushave të mbështetura, dhe e numrit dhe vlerës së donacioneve të evidentuara nga organet publike. Publikimi i informacionit bëhet sipas rregullave të aksesit dhe të mbrojtjes së të dhënave.
4. Forcimi i mekanizmave të verifikimit dhe kontrollit administrativ brenda 2 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit, duke arritur: rritjen me të paktën 30% të numrit të kontrolleve dhe verifikimeve administrative, krahasuar me nivelin fillestar.
5. Rritja e efektivitetit në identifikimin dhe trajtimin e shkeljeve administrative, duke siguruar: shqyrtimin 100% të rasteve të konstatuara dhe zbatimin e masave disiplinore ose sanksioneve administrative, sipas natyrës së shkeljes dhe kompetencës së autoritetit, përfshirë: mosdeklarimin, deklarimin e pasaktë, shkeljet e konfliktit të interesit, vendosjen e masave administrative për çdo rast të konstatuar.
6. Fuqizimi i rolit mbikëqyrës të autoriteteve përgjegjëse dhe rritja e zbatueshmërisë së ligjit, duke arritur: rritjen e numrit të masave administrative dhe sanksioneve të vendosura në përputhje me shkeljet e konstatuara.

Për arritjen e objektivave të kësaj nisme, rezultatet e tyre do të maten me tregues performance agreguar në objektivët e lartpërmendr.

Më konkretisht, treguesit do të konsistojnë në: bërjen funksionalë plotësisht të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve; deklarime dhe publikime të plota të të dhënave lidhur me donacionet e përfituara nga organet publike; transparencë dhe gjurmueshmëri e plotë; si dhe mekanizmat e kontrollit administrativ dhe të zbatimit të masave administrative të parashikuara në projektligj, plotësisht funksionale.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 0 (*status quo*): **Vijimi i zbatimit të kuadrit ekzistues rregullator (ligji nr. 7892/1994 "Për sponsorizimet" dhe dispozita të shpërndara në legjislacionin tatimor)**

Avantazhe: Nuk kërkon ndryshime ligjore, nuk krijon kosto të reja administrative dhe nuk kërkon ngritjen e mekanizmave të rinj institucionalë (p.sh. Regjistri Elektronik Kombëtar i Sponsorizimeve).
Disavantazhe: Kuadri ekzistues është i vjetëruar dhe i fragmentuar për sponsorizimet, mungojnë rregulla për donacionet në organet publike, mekanizma transparence dhe kontrolli, nuk adresohen risqet e konfliktit të interesit, pastrimit të parave dhe ndikimit të papërshtatshëm në vendimmarrje, mungon një regjistër i unifikuar dhe publik.

Opsioni 1 (rregullator): Ndryshime (amendime) të pjesshme në legjislacionin ekzistues për sponsorizimet dhe në ligjin tatimor.

Avantazhe: Ky opsion sjell kosto më të ulëta rregullatore, ndërhyrje e kufizuar pa krijimin e një kuadri të ri të plotë, si dhe ruhet vazhdimësia e praktikave ekzistuese.
Disavantazhe: Ndryshimet e pjesshme në legjislacionin ekzistues ose ndërhyrjet e kufizuara përmes akteve nënligjore nuk do të garantonin krijimin e një sistemi të unifikuar dhe të qëndrueshëm për regjistrimin, publikimin dhe monitorimin e donacioneve dhe sponsorizimeve. Kjo qasje do të vijonte fragmentarizimin normativ dhe do të kufizonte efektivitetin e masave parandaluese kundër konfliktit të interesit, pastrimit të parave dhe ndikimeve të papërshtatshme në vendimmarrjen me interes publik.

Opsioni 2 (rregullator): Miratimi i një ligji të ri "Për Donacionet dhe Sponsorizimet".

Avantazhe: Ky opsion përfaqëson mjetin më të përshtatshëm të ndërhyrjes për të adresuar në mënyrë të plotë shkaqet themelore të problemit. Ky ndryshim politikash krijon bazën për vendosjen e standardeve të qarta dhe të detyrueshme ligjore, për regjistrimin elektronik të centralizuar, për verifikimin e kritereve ligjore dhe për koordinimin ndërinstitucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse.
Disavantazhe: Implementimi i këtij opsioni kërkon angazhim administrativ dhe financiar për ngritjen dhe mirëmbajtjen e Regjistrit Elektronik, shton barrë dokumentare për subjektet përfituese dhe sponsorizuesit, si dhe kërkon hartimin e akteve nënligjore dhe zhvillimin e trajnimeve për zbatimin efektiv.

Opsioni 3 (jorregullator): **Hartimi i udhëzimeve administrative, kodeve etike dhe masave vetërregulluese institucionale.**

Avantazhe: Kosto më të ulëta dhe fleksibilitet më i madh për institucionet dhe subjektet private. Nëpërmjet këtij opsioni mund të rritet ndërgjegjësimi për integritetin dhe transparencën.
Disavantazhe: Ky opsion nuk krijon detyrim ligjor dhe mekanizma sanksionuese, nuk siguron transparencë të unifikuar, nuk garanton kontroll efektiv financiar dhe fiskal. Përpjektet e realizuara nëpërmjet këtij opsioni mbeten të pamjaftueshme për të adresuar risqet e pastrimit të parave, konfliktit të interesit dhe ndikimit të papërshtatshëm në organet publike.

Opsioni i preferuar është opsioni 2: **Miratimi i një ligji të ri "Për Donacionet dhe Sponsorizimet".**

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Opsioni i preferuar (Opsioni 2), që parashikon miratimin e ligjit "Për Donacionet dhe Sponsorizimet", pritet të ketë ndikime pozitive afatgjata në transparencë, integritet institucional dhe besimin publik si dhe ndikime të drejtpërdrejta buxhetore, administrative dhe fiskale.

Nisma ligjore pritet të gjenerojë ndikime pozitive cilësore dhe afatgjata:

1. Rritje e transparencës përmes publikimit nga organet publike të informacionit për donacionet e pranuara dhe të kontratave e raporteve të sponsorizimit, sipas neneve 21 dhe 24. Autoritetet kompetente kanë akses në të dhënat e Regjistrit sipas kompetencave dhe niveleve të përcaktuara. Të dhënat e Regjistrit për sponsorizimet e përfituara nga subjektet e nenit 4, pika 5, nuk janë të aksesueshme për publikun.
2. Forcim të kontrollit financiar dhe fiskal, përmes gjurmueshmërisë së fondeve dhe kontrollit të risqeve të pastrimit të parave, deklarimeve fiktive dhe përdorimit abuziv të lehtësive tatimore.
3. Parandalim të konfliktit të interesit dhe ndikimeve të papërshtatshme, duke kufizuar përdorimin e donacioneve dhe sponsorizimeve si instrument informal për ushtrimin e ndikimit në vendimmarrjen publike.
4. Mbështetje për artin, sportin, kulturën dhe veprimtari të tjera me interes publik, në një kuadër transparent dhe të kontrolluar, duke orientuar sponsorizimet drejt qëllimeve legjitime dhe me vlera shoqërore.
5. Përmirësim të besimit publik në administratën shtetërore dhe në mënyrën e përdorimit të fondeve dhe burimeve me interes publik, si dhe përmirësim të perceptimit mbi integritetin institucional.

Neni 14 parashikon njohjen e sponsorizimit si shpenzim të zbritshëm në regjimin e përgjithshëm, me formulimin "jo më pak se 3 për qind të tatim fitimit". Për sponsorizimet në art, kulturë dhe sport, neni 15 parashikon një lehtësi të posaçme deri në 30 për qind të tatimit mbi fitimin, me bazë llogaritjeje sipas formës së sponsorizimit dhe kufij vjetorë që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Efekti shtesë mbi të ardhurat tatimore, krahasuar me kuadrin ekzistues, mbetet i papërllogaritur.

Megjithatë, këto kosto konsiderohen të përballueshme dhe proporcionale, duke marrë parasysh përfitimet afatgjata që lidhen me transparencën, kontrollin fiskal dhe parandalimin e abuzimeve të mundshme.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar është **Opsioni 2: miratimi i një ligji të ri "Për Donacionet dhe Sponsorizimet"**, si zgjidhja më e plotë dhe koherente për rregullimin e kësaj fushe. Ky opsion

përcakton rregullat për regjistrimin kombëtar të sponsorizimeve dhe për evidentimin e publikimin proaktiv të donacioneve nga organet publike.

Ky opsion vendos për herë të parë një kuadër të unifikuar dhe detyrues ligjor, i zbatueshëm për të gjithë subjektet e përfshira, duke përcaktuar rregulla të qarta për donacionet dhe sponsorizimet për organet publike, si dhe për sponsorizimet për organizatat jofitimprurëse dhe organizat të tjera, në përputhje me parimet e transparencës, llogaridhënies dhe interesit publik.

Opsioni i preferuar parashikon që sponsorizimet të regjistrohen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe që organet publike të evidentojnë donacionet e pranuara e të publikojnë informacion për to në Programin e Transparencës. Njëkohësisht, forcohet roli i autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të ligjit, duke kontribuar në parandalimin e përdorimit abuziv të donacioneve dhe sponsorizimeve, forcimin e integritetit institucional dhe rritjen e besimit publik në marrëdhëniet ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe shoqërisë civile.

Opsionet e tjera, si ruajtja e *status quo*-së apo ndryshimet e pjesshme në legjislacionin ekzistues, nuk sigurojnë mekanizma të mjaftueshëm kontrolli, gjurmueshmërie dhe shmangieje të konfliktit të interesit.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
0	**10,257,647**	**4,858,376**

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Projektligji "Për Donacionet dhe Sponsorizimet" është publikuar në RENJKP për një periudhë 20 ditore pune. Paralelisht, procesi i hartimit dhe konsultimit është zhvilluar përmes Grupit Ndërinstitucional të Punës, e të sekretariatit teknik pranë drejtuesit Grupit Ndërinstitucional të Punës nëpërmjet takimeve teknike të punë dhe një tryeze të hapur konsultative, me përfshirjen e institucioneve publike, shoqërisë civile, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë. Nga konsultimi pranë RENJKP, janë marrë gjithsej **276** komente nga subjekte të interesuara, nga të cilat **111** janë pranuar, **52** pranuar pjesërisht dhe **113** janë refuzuar. Këto komente kanë ardhur nga grupe interesi (OSHC) më vehte dhe të grupuara, si: grup organizatash të Shëndetësisë (Fondacioni "Pema e Jetës", Qendra HAP (Health for All), Shoqata "Together for Life", Unioni i Inxhinierëve Shqiptare, Hemofilia Shqiptare, Shoqata "Autizmi Flet", Qendra Social Kulturore "Edhe une mundem" dhe Konsulenti: ICM Healthcare), organizatat për P.A.K. (Fondacioni "Down Syndrome Albania"(DSA), Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (SHDPAK / ADRF), Caritas Albania, Shoqata "Ndihmoni Jetën", Fondacioni "Së Bashku", MEDPAK (Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara), ANAD (Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë), Shoqata "Vizion OJF", Klub Kombëtar i Prindërve me CSA & PAK dhe Global Care Albania), Partners Albania, IDM Albania, Komuniteti Musliman Shqiptar, ICC Albania, Bashkimi Tregtar i Shqipërisë, federata sportive, AMCham, UNICEF, OSCE, etj, si dhe qytetarë të interesuar që kanë dhënë komente nëpërmjet formatit elektronik të RENJK, në rrugë elektronik dhe atë shkresore. Në përfundim të periudhës së konsultimit RENJK ka shënuar **1822** shikime në total.

Procesi i hartimit dhe konsultimit të projektligjit "Për Donacionet dhe Sponsorizimet" është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës së hartimit, përmes diskutimeve tematike të Grupit Ndërinstitucional të Punës, me asistencën teknike të projektit EU4GG të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë. Diskutimet kanë përfshirë ministritë, e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe, të Financës me një kontribut specifik të stukturave teknike të administrojnë dhe hartojnë paketën fiskale si dhe autoritete me kompetenca antikorrupsioni. Shoqëria civile dhe sektori privat kanë shprehur një interes të posaçëm për çështje të veçanta si fusha e veprimit, masat e incentivave fiskale, si dhe modifikimin strukturave të integritetit. Kontributet e marra gjatë këtyre takimeve janë reflektuar në mënyrë të strukturuar në hartimin dhe dhe rishikimin e projektligjit.
Konsultimi publik dhe i dedikuar teknik është zhvilluar në periudhën tetor 2025-shkurt 2026.

Në përfundim, procesi i konsultimit publik ka shërbyer si një instrument thelbësor për rritjen e transparencës, përfshirjes së palëve të interesuara dhe cilësisë së nismës ligjore, duke përmirësuar qartësinë, zbatueshmërinë dhe përputhshmërinë e projektligjit "Për Donacionet dhe Sponsorizimet" me standardet evropiane, pa ndryshuar strukturën dhe konceptin e tij bazë.

Komentet dhe sugjerimet e marra janë përqendruar kryesisht në: (1) fushën e zbatimit të projektligjit dhe qasjen e tij me kuadrin ekzistues ligjor për organizatat jofitimprurëse; (2) regjimin e lehtësive tatimore dhe proporcionalitetin e incentivave fiskale ndërmjet fushave të ndryshme me interes publik; (3) kërkesat për transparencë, dokumentacion dhe regjistrim në Regjistrin Kombëtar Elektronik që ligji parashikon; (4) përkufizimet ligjore dhe kategoritë e subjekteve përfituese dhe sponsorizuese; si dhe (5) mekanizmat e kontrollit dhe masat parandaluese në funksion të integritetit dhe shmangies së konfliktit të interesit.

Një pjesë e konsiderueshme e komenteve janë adresuar nga organizata të shoqërisë civile aktive në fushën e shëndetësisë, aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve sociale (si më lart cituar), të cilat kanë kërkuar zgjerimin e fushës së lehtësirave fiskale, rishikimin e disa kërkesave procedurale dhe garantimin e një trajtimi proporcional ndërmjet fushave të ndryshme të interesit publik. Komente të tjera janë fokusuar në qartësimin e marrëdhënies ndërmjet donacioneve, sponsorizimeve dhe kuadrit ligjor ekzistues për organizatat jofitimprurëse, si dhe në rritjen e standardeve të transparencës dhe regjistrimit.

Kontributet e marra gjatë procesit të konsultimit janë reflektuar pjesërisht ose plotësisht në përmbajtjen e projektligjit, kryesisht nëpërmjet: riformulimit të disa përkufizimeve, rishikimit të kërkesave dokumentare, saktësimit të dispozitave mbi regjistrimin dhe transparencën, si dhe përmirësimit të disa dispozitave në funksion të qartësisë dhe zbatueshmërisë së normës.

Në përfundim, procesi i konsultimit publik ka shërbyer si një instrument thelbësor për rritjen e transparencës, përfshirjes së palëve të interesuara dhe cilësisë së nismës ligjore, duke përmirësuar qartësinë, zbatueshmërinë dhe përputhshmërinë e projektligjit "Për Donacionet dhe Sponsorizimet" me standardet evropiane, pa ndryshuar strukturën dhe konceptin e tij bazë.

Në lidhje me komentet konkrete, të pranuara plotësisht, pjesërisht ose të refuzuara për secilin grup interesi, tabela e konsultimit publik përmban arsyetimet dhe shpjegimet përkatëse.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Zbatimi i ligjit "Për donacionet dhe sponsorizimet" do të realizohet në mënyrë të koordinuar ndërinstitucionale, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve administron Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe ushtron kompetencat e kontrollit tatimor. Përfituesi regjistron sponsorizimin

nëpërmjet shërbimit në e-Albania brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe përditëson të dhënat brenda 30 ditëve nga ndryshimi i saj, sipas nenit 11. Palët hedhin në Regjistër raportin e përbashkët brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të kontratës. Organi publik publikon kontratën e sponsorizimit brenda 10 ditëve nga nënshkrimi dhe raportin e zbatimit sipas nenit 21. Për donacionet, organi publik kryen evidentimin dhe publikimin sipas nenit 24. Autoritetet kompetente kanë akses në të dhënat e Regjistrit sipas nenit 10 dhe Agjencia e Inteligjencës Financiare ka akses në dokumentacionin e përcaktuar në nenin 17.

Efektiviteti i zbatimit dhe monitorimit të nismës ligjore do të vlerësohet përmes treguesve të performancës, të cilët lidhen drejtpërdrejt me transparencën, raportimin, kontrollin dhe integritetin e përdorimit të donacioneve dhe sponsorizimeve.

Më konkretisht, treguesit e matshëm të monitorimit paraqiten edhe si më lart, në rubrikën "Objektivat dhe rezultatet e synuara":

1. Numri dhe vlera e sponsorizimeve të deklaruara pranë DPT-së gjatë periudhës kalimtare ose të regjistruara pas vënies në funksion të shërbimit elektronik. Të dhënat e transferuara numërohen një herë.
2. Përqindja e sponsorizimeve të regjistruara brenda afatit dhe përqindja e raporteve të sponsorizimit të dorëzuara brenda afatit, të matura veçmas.
3. Numri dhe vlera e donacioneve të evidentuara nga organet publike dhe përqindja e donacioneve për të cilat është publikuar informacioni i kërkuar.
4. Përqindja e kontratave dhe raporteve të sponsorizimit të publikuara sipas nenit 21 dhe përqindja e publikimeve për donacionet financiare të kryera brenda afateve të posaçme të nenit 24.
5. Numri i rasteve të verifikimit dhe kontrollit administrativ të kryera nga autoritetet përgjegjëse mbi deklarimin dhe përdorimin e donacioneve dhe sponsorizimeve.
6. Numri dhe lloji i shkeljeve administrative të konstatuara, përfshirë rastet e mosdeklarimit, deklarimit të pasaktë ose shkeljes së rregullave për konfliktin e interesit.
7. Numri i masave administrative dhe sanksioneve të vendosura, si rezultat i shkeljeve të konstatuara gjatë zbatimit të ligjit.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Kuadri ligjor shqiptar aktualisht nuk përmban një rregullim të posaçëm, të unifikuar dhe gjithëpërfshirës për donacionet dhe sponsorizimet në mbështetje të veprimtarive me interes publik. Rregullimet ekzistuese janë të shpërndara dhe fragmentare, të përfshira kryesisht në legjislacionin tatimor, në ligjin për organizatat jofitimprurëse, në legjislacionin për sportin, si dhe në disa akte të tjera nënligjore që rregullojnë menaxhimin financiar dhe buxhetor në sektorin publik. Këto dispozita ofrojnë mbulim të pjesshëm dhe jo të harmonizuar, gjë e cila ka konkluduar në mungesën e një kuadri të integruar për transparencën, regjistrimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e donacioneve dhe të sponsorizimeve.

Donacionet dhe sponsorizimet për organet publike, si dhe sponsorizimet për organizatat jofitimprurëse janë administruar kryesisht mbi baza kontraktuale dhe përmes rregullave të brendshme administrative, por pa një mekanizëm të detyrueshëm dhe të standardizuar publikimi, raportimi dhe monitorimi. Mungesa e një regjistri kombëtar dhe e procedurave të harmonizuara ka krijuar boshllëqe të konsiderueshme në gjurmueshmërinë e fondeve, në verifikimin e burimit dhe destinacionit të tyre, si dhe në identifikimin dhe parandalimin e situatave të konfliktit të interesit dhe ndikimeve të papërshtatshme.

Në këtë kontekst është përgatitur një dokument teknik analitik, i cili ka kryer një vlerësim të detajuar të kuadrit ligjor dhe rregullator ekzistues në lidhje me donacionet dhe sponsorizimet me interes publik.
Analiza ka evidentuar se rregullimi aktual i sponsorizimeve mbështetet kryesisht në ligjin nr. 7892/1994 "Për sponsorizimet", si dhe në dispozita të veçanta të legjislacionit tatimor dhe sektorëve specifikë, si sporti, kultura dhe arti, të cilat fokusohen kryesisht në lehtësitë fiskale dhe jo në transparencën, kontrollin dhe gjurmueshmërinë e fondeve.

Nga ana tjetër, donacionet veçanërisht ato të dhëna për organet publike, nuk rregullohen nga një ligj i posaçëm. Dokumenti teknik evidenton se ato trajtohen në mënyrë të tërthortë dhe të copëzuar përmes:

- legjislacionit për menaxhimin financiar dhe buxhetor në sektorin publik,
- rregullave për administrimin e pasurisë dhe fondeve publike,
- dispozitave për kontrollin financiar dhe auditimin,
- si dhe përmes praktikave kontraktuale dhe rregulloreve të brendshme të institucioneve.

Po ashtu, ligji për organizatat jofitimprurëse rregullon në mënyrë të përgjithshme pranimin e fondeve dhe burimeve financiare nga këto subjekte, por nuk vendos standarde të detajuara dhe të detyrueshme për regjistrimin, publikimin dhe monitorimin e sponsorizimeve me interes publik, as për raportimin e tyre në një mekanizëm të unifikuar kombëtar.

Dokumenti teknik konstaton se kjo ndarje e shpërndarë e rregullimit ligjor ka sjellë mungesë të procedurave të harmonizuara, mungesë të një mekanizmi të vetëm regjistrimi dhe transparence, si dhe boshllëqe në verifikimin e burimit dhe përdorimit të fondeve, në parandalimin e konfliktit të interesit dhe në koordinimin ndërinstitucional për qëllime kontrolli, monitorimi dhe parandalimi të abuzimeve.

Në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe forcimit të politikave të qeverisjes së mirë, transparenca financiare dhe llogaridhënia në përdorimin e fondeve me interes publik përbëjnë elemente thelbësore të sundimit të ligjit. Gjithashtu, zhvillimet në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për parandalimin e pastrimit të parave kanë kërkuar harmonizim më të mirë të praktikave administrative me standardet bashkëkohore të kontrollit dhe raportimit.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Përshkruani natyrën e problemit

Pavarësisht ekzistencës së disa rregullimeve të pjesshme ligjore dhe tatimore, kuadri ligjor shqiptar aktualisht nuk përmban një rregullim të posaçëm, të unifikuar dhe gjithëpërfshirës për donacionet dhe sponsorizimet në mbështetje të veprimtarive me interes publik. Rregullimet ekzistuese janë të fragmentuara dhe të shpërndara në legjislacionin tatimor, ligjin për organizatat jofitimprurëse, legjislacionin për sportin dhe akte të tjera sektoriale, pa krijuar një sistem të centralizuar për regjistrimin, raportimin dhe transparencën e këtyre marrëdhënieve financiare.

Si pasojë e kësaj qasjeje të copëzuar, donacionet dhe sponsorizimet për organet publike, si dhe sponsorizimet për organizatat jofitimprurëse, zhvillohen me nivele të ndryshme formalizimi, mbi baza kontraktuale ose rregulla të brendshme administrative, pa standarde të njëjta dhe të detyrueshme kontrolli, publikimi dhe monitorimi. Mungesa po ashtu e një mekanizmi të unifikuar dhe të detyrueshëm regjistrimi, veçanërisht për rastet kur përfitues janë organet publike, bën që këto marrëdhënie të mbeten pjesërisht të padokumentuara dhe jo plotësisht transparente për publikun dhe institucionet mbikëqyrëse.

Problemi themelor qëndron në mungesën e një sistemi të strukturuar dhe të besueshëm për gjurmueshmërinë dhe verifikimin e fondeve, përfshirë burimin, destinacionin dhe kushtet e përdorimit të tyre. Kjo situatë krijon risqe të shtuara për konflikt interesi, ndikim të papërshtatshëm në vendimmarrjen publike, pastrim parash dhe përdorim jo transparent të fondeve, si dhe vështirësi në kontrollin e përfitimit dhe përdorimit të lehtësive tatimore.

Për më tepër, mungesa e procedurave të harmonizuara dhe e një regjistri publik cenon sigurinë juridike për subjektet private, organizatat jofitimprurëse dhe institucionet publike, duke krijuar pasiguri mbi rregullat e aplikueshme dhe përgjegjësitë përkatëse. Kjo situatë ndikon negativisht në besimin e publikut ndaj administrimit të fondeve dhe mbështetjeve për veprimtari me interes publik dhe në perceptimin e integritetit të marrëdhënieve ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe të shoqërisë civile.

Në këtë kuadër, problemi që synohet të adresohet lidhet me ekzistencën e një boshlleku të dukshëm ndërmjet praktikës aktuale dhe nevojës për standarde të unifikuara transparence, kontrolli dhe llogaridhënieje, duke kufizuar rolin e rregullimit të donacioneve dhe sponsorizimeve si instrument parandalues për forcimin e integritetit institucional, transparencës financiare dhe sundimit të ligjit, në përputhje me objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030.

Identifikoni shkaqet e problemit

Shkaku kryesor është mungesa e një kuadri ligjor të posaçëm, të unifikuar dhe të detyrueshëm që të rregullojë në mënyrë të integruar donacionet dhe sponsorizimet në të gjitha fushat me interes publik. Në mungesë të këtij kuadri ligjor, marrëdhëniet financiare ndërmjet sektorit privat, organeve publike dhe subjekteve të tjera përfituese zhvillohen mbi baza të pjesshme rregullimi, pa standarde të njëjta transparence, kontrolli dhe llogaridhënieje.

Një tjetër shkak lidhet me fragmentarizimin e dispozitave ekzistuese, të cilat trajtojnë vetëm aspekte të veçanta (tatimore, administrative apo sektoriale), pa vendosur detyrime të qarta për regjistrim, publikim dhe verifikim të burimit të fondeve. Këto dispozita nuk vendosin detyrime të qarta për regjistrimin, publikimin dhe verifikimin e burimit të fondeve, duke krijuar boshllëqe të konsiderueshme sa i takon transparencës dhe kontrollit.

Problemi tjetër është nga mungesa e një mekanizmi të centralizuar elektronik dhe institucional, i cili të mundësojë regjistrimin e detyrueshëm dhe gjurmueshmërinë e sponsorizimeve, krahas evidentimit dhe

publikimit të donacioneve të pranuara nga organet publike në shkallë kombëtare. Mungesa e këtij mekanizmi, si dhe e një koordinimi të strukturuar ndërinstitucional, kufizon ndjeshëm kapacitetet e shtetit për monitorim efektiv, për identifikimin e konflikteve të interesit dhe për parandalimin e abuzimeve të mundshme, përfshirë risqet e pastrimit të parave dhe ndikimeve të papërshtatshme në vendimmarrjen publike.

Gjithashtu, mungesa e një rregullimi të qartë dhe të detyrueshëm ligjor ka penguar ndërtimin e një kulture të konsoliduar transparence dhe integriteti në menaxhimin e donacioneve dhe sponsorizimeve, si në administratën publike, ashtu edhe në marrëdhëniet e sektorit privat dhe shoqërinë civile.

Në këtë kontekst, problematika lidhet edhe me nevojën për forcimin e standardeve të transparencës dhe integritetit në përputhje me praktikat e mira të qeverisjes dhe politikat kundër korrupsionit, duke kufizuar përdorimin e rregullimit të donacioneve dhe sponsorizimeve si një instrument parandalues për forcimin e integritetit institucional dhe llogaridhënies publike, në përputhje me objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030.

Përshkruani shtrirjen e problemit

Mungesa e një rregullimi të unifikuar për donacionet dhe sponsorizimet ka shtrirje të gjerë dhe ndërsektoriale, pasi prek një numër të madh aktorësh dhe sektorësh që përfshihen në financimin dhe mbështetjen e veprimtarive me interes publik. Ai prek drejtpërdrejt organet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor, organizatat jofitimprurëse, organizatat sportive, institucionet kulturore, si dhe subjektet private dhe individët që kontribuojnë financiarisht në këto fusha.

Si pasojë e mosrregullimit të mirë, nuk ekzistojnë të dhëna të plota, të konsoliduara dhe të krahasueshme mbi vlerën, burimin, destinacionin dhe qëllimin e donacioneve dhe sponsorizimeve në nivel kombëtar. Kjo mungesë e informacionit e bën të vështirë vlerësimin real të shkallës së fenomenit, identifikimin e risqeve dhe ushtrimin e monitorimit efektiv nga institucionet përgjegjëse por edhe opinioni publik.

Shtrirja e problemit është në nivel qendror, ashtu edhe në atë vendor, dhe përfshin sektorë me rëndësi të veçantë për interesin publik, si kultura, sporti, arsimi, shëndetësia, mjedisi dhe fusha të tjera ku ndërveprimi ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe shoqërisë civile është i shpeshtë. Në këto sektorë, mungesa e standardeve të njëjta për transparencën dhe kontrollin krijon praktika të ndryshme administrative dhe nivele të pabarabarta formalizimi.

Problemi paraqitet edhe në besimin publik, pasi mungesa e gjurmueshmërisë dhe transparencës mbi donacionet dhe sponsorizimet, veçanërisht kur përfitues janë organet publike, rrit perceptimet për ndikim të papërshtatshëm, konflikt interesi apo përdorim jo të drejtë të fondeve. Kjo situatë ndikon negativisht në perceptimin e integritetit institucional dhe bie ndesh me standardet e qeverisjes së mirë dhe transparencës financiare të promovuara nga Bashkimi Evropian dhe organizatat ndërkombëtare.

Në këtë kuptim, shtrirja e problemit nuk është e kufizuar në raste të izoluara apo sektorë të veçantë, por paraqet një problem sistemik, që kërkon ndërhyrje të koordinuar dhe të strukturuar ligjore për të garantuar transparencë, barazi dhe llogaridhënie në përdorimin e fondeve dhe mbështetjeve për veprimtari me interes publik.

Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët

Qeveria dhe institucionet publike: Mungesa e një sistemi të unifikuar ligjor për rregullimin e donacioneve dhe sponsorizimeve rrit risqet për vendimmarrje jo transparente dhe krijon perceptime negative mbi integritetin e institucioneve publike. Institucionet publike përballen me vështirësi në mbikëqyrjen, verifikimin dhe gjurmueshmërinë e burimeve financiare të përfituara, gjë e cila kufizon kapacitetin e tyre për të garantuar llogaridhënie, për të parandaluar konfliktin e interesit dhe për të zbatuar në mënyrë të qëndrueshme standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të transparencës dhe qeverisjes së mirë.

Sektori privat (bizneset dhe sponsorizuesit): Subjektet private që ofrojnë donacione ose sponsorizime operojnë aktualisht në një mjedis rregullator të paqartë dhe të fragmentuar, i cili krijon pasiguri juridike dhe trajtim jo të barabartë ndërmjet aktorëve ekonomikë. Mungesa e rregullave të unifikuara dhe e procedurave të standardizuara për deklarimin, regjistrimin dhe përfitimin e lehtësive tatimore rrit rrezikun e interpretimit të ndryshëm të ligjit dhe kufizon sigurinë ligjore për biznesin.

Organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat e sektorëve të tjerë: Organizatat jofitimprurëse dhe ato që operojnë në sektorë si sporti, subjektet tregtare në fushën e prodhimit të filmit dhe industrisë audioviziv apo individë që përfaqësojnë vendin në aktivitete ndërkombëtare në fushën e artit, sportit, kulturës si përfitues të sponsorizimeve dhe mbështetjeve financiare, përballen me standarde të ndryshme raportimi. Mungesa e një sistemi të konsoliduar dhe transparent për regjistrimin e donacioneve dhe sponsorizimeve kufizon aftësinë e këtyre organizatave për të rritur besueshmërinë e tyre ndaj publikut, donatorëve dhe institucioneve mbikëqyrëse, si dhe për të demonstruar përdorimin e fondeve në përputhje me qëllimet e interesit publik.

Qytetarët: publiku preket në mënyrë të tërthortë nga mungesa e transparencës dhe gjurmueshmërisë mbi financimin e veprimtarive me interes publik, veçanërisht kur përfitues janë organet publike. Kjo situatë ndikon negativisht në nivelin e besimit ndaj institucioneve publike, në perceptimin e drejtësisë dhe integritetit institucional, si dhe në besimin se fondet dhe mbështetjet financiare përdoren në mënyrë të ligjshme dhe në interes të komunitetit.

Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave

Problemi i identifikuar mund të trajtohet përmes një ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë në nivel politikash publike, pasi lidhet me ekzistencën e një boshllëku strukturor në kuadrin rregullator për donacionet dhe sponsorizimet në mbështetje të veprimtarive me interes publikaq sa edhe ligjor. Në kushtet aktuale, me rregullimet e shpërndara dhe fragmentare nuk ofrojnë një bazë të mjaftueshme për transparencë, kontroll dhe gjurmueshmëri, duke e bërë të pamundur adresimin e plotë të risqeve të identifikuara për integritetin institucional.

Përmes kësaj ndërhyrjeje, politika publike synon të forcojë integritetin institucional, të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në administrimin e mbështetjeve financiare për veprimtari me interes publik dhe të kontribuojë në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm parandalues, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*

- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë

Qeveria shqiptare e sheh të domosdoshme ndërhyrjen për krijimin e një kuadri ligjor të posaçëm, gjithëpërfshirës dhe detyrues, i cili të rregullojë në mënyrë të qartë transparencën, integritetin dhe llogaridhënien në marrjen, përdorimin dhe raportimin e donacioneve dhe sponsorizimeve nga subjektet private drejt institucioneve publike dhe subjekteve të tjera përfituese me interes publik. Ndërhyrja është e nevojshme për të adresuar boshllëkun aktual rregullator, ku donacionet dhe sponsorizimet zhvillohen mbi baza të fragmentuara, pa standarde të unifikuara dokumentimi, regjistrimi dhe mbikëqyrjeje, duke krijuar hapësira për ndikime të papërshtatshme, konflikt interesi dhe përdorim jo transparent të fondeve.

Mungesa e një kornize të detyrueshme ligjore dhe e një mekanizmi të centralizuar transparence e bën të vështirë gjurmueshmërinë e burimit dhe destinacionit të fondeve, veçanërisht në rastet kur përfitues janë organet publike. Kjo situatë rrit risqet për cenimin e integritetit institucional dhe ndikon negativisht në besimin e publikut ndaj administrimit të mbështetjeve financiare për veprimtari me interes publik.

Nevoja për ndërhyrje është evidentuar gjithashtu në kuadër të angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë dhe rekomandimeve të dhëna nga Komisioni Evropian dhe Këshilli i Evropës, të cilat theksojnë rëndësinë e vendosjes së standardeve të qarta për menaxhimin transparent të marrëdhënieve financiare ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, si pjesë e forcimit të sundimit të ligjit dhe parandalimit të korrupsionit. Në këtë kuadër, ndërhyrja e qeverisë synon të formalizojë proceset e pranimit, regjistrimit, raportimit dhe kontrollit të donacioneve dhe sponsorizimeve, duke garantuar që ato të jenë të ligjshme, të verifikueshme dhe të orientuara drejt interesit publik.

Shkalla e ndërhyrjes konsiderohet e nevojshme, pasi adresimi i problematikës nuk mund të arrihet përmes ndryshimeve të pjesshme apo rregullimeve të veçuara, të cilat do të vijonin fragmentarizimin normativ dhe nuk do të garantonin krijimin e një sistemi të unifikuar, të detyrueshëm dhe të qëndrueshëm për transparencën, regjistrimin, gjurmueshmërinë dhe monitorimin e donacioneve dhe sponsorizimeve në mbështetje të veprimtarive me interes publik. Kjo nismë mbështetet në analizën paraprake të kuadrit ekzistues, konsultime ndërinstitucionale dhe asistencë teknike nga partnerët ndërkombëtarë, duke siguruar harmonizimin me standardet evropiane dhe praktikat më të mira. Në këtë kuptim, ndërhyrja përfaqëson një hap të qëndrueshëm politik dhe institucional drejt forcimit të integritetit publik, mbrojtjes së fondeve me interes publik dhe rritjes së besimit të qytetarëve në institucionet shtetërore.

Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje

Përmes kësaj ndërhyrjeje, qeveria synon të adresojë mungesën aktuale të transparencës, standardizimit dhe kontrollit në pranimin, përdorimin dhe raportimin e donacioneve dhe sponsorizimeve në mbështetje të veprimtarive me interes publik, veçanërisht kur përfitues janë institucionet publike. Ndërhyrja synon të krijojë një kuadër të qartë dhe të unifikuar ligjor për regjistrimin e detyrueshëm, deklarimin dhe gjurmueshmërinë e këtyre mbështetjeve financiare, duke siguruar që ato të jenë të ligjshme, të verifikueshme dhe të përdorura në përputhje me qëllimin e interesit publik.

Qeveria synon gjithashtu të forcojë mekanizmat e llogaridhënies dhe mbikëqyrjes institucionale, përmes vendosjes së procedurave konkrete, rregullave të qarta për konfliktin e interesit dhe koordinimit ndërinstitucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse. Në këtë mënyrë, ndërhyrja synon të reduktojë edhe

risqet e ndikimeve të mundshme të papërshtatshme, të pastrimit të parave dhe përdorimit jo transparent të fondeve, duke rritur më shumë eficencën e përdorimit të tyre nga subjektet përfituese dhe sponsorizuesit.

Njëkohësisht, kjo ndërhyrje synon të rrisë besimin e publikut në administrimin e fondeve dhe mbështetjeve financiare private për veprimtari me interes publik, si dhe të kontribuojë në përmbushjen e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030, duke e konsoliduar këtë fushë si një instrument parandalues për forcimin e integritetit publik.

Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë

Kjo nismë mbështet drejtpërdrejt objektivat e qeverisë për forcimin e sundimit të ligjit, rritjen e transparencës dhe integritetit në administrimin e fondeve dhe mbështetjeve financiare private me interes publik, si dhe parandalimin e korrupsionit, në përputhje me prioritetet strategjike kombëtare. Rregullimi i donacioneve dhe sponsorizimeve përbën një komponent të rëndësishëm të arkitekturës parandaluese ligjore të integritetit, duke synuar reduktimin e hapësirave për ndikime të papërshtatshme dhe konflikte interesi në marrëdhëniet ndërmjet sektorit publik dhe atij privat.

Nisma lidhet drejtpërdrejt me objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030, por edhe me angazhimet e marra në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, duke kontribuar në forcimin e mekanizmave parandalues ndaj përdorimit jo transparent të fondeve, rritjen e integritetit institucional dhe përmirësimin e transparencës në qeverisje. Mungesa e një kuadri ligjor të posaçëm për donacionet dhe sponsorizimet është identifikuar si risk për integritetin e proceseve vendimmarrëse, pasi krijon hapësira për praktika jo transparente dhe konflikte interesi të pamenaxhuara. Kjo ndërhyrje adreson këtë boshllëk përmes vendosjes së rregullave të qarta për regjistrimin, deklarimin, gjurmueshmërinë dhe mbikëqyrjen e këtyre fondeve.

Regjistrimi i detyrueshëm elektronik i sponsorizimeve përmes shërbimit në e-Albania dhe administrimi i të dhënave nga DPT-ja dhe evidentimi e publikimi i donacioneve nga organet publike forcojnë llogaridhënien dhe u mundësojnë autoriteteve kompetente të verifikojnë përdorimin e mbështetjes së përfituar.

Njëkohësisht, nisma mbështet objektivat për rritjen e transparencës dhe përfshirjes së publikut në proceset me interes publik, duke garantuar barazi aksesi për të gjithë aktorët dhe duke forcuar rolin mbikëqyrës të shoqërisë civile dhe publikut. Në këtë kuptim, ndërhyrja shërben si instrument parandalues dhe strukturor për zbatimin efektiv të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, forcimin e qeverisjes së hapur dhe përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane.

Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë

Në mungesë të një kuadri të posaçëm të plotë ligjor për rregullimin e donacioneve dhe sponsorizimeve, qeveria dhe institucionet publike kanë ndërmarrë në vite një sërë masash dhe instrumentesh me synim forcimin e integritetit institucional, rritjen e transparencës dhe parandalimin e ndikimeve të papërshtatshme në vendimmarrjen publike.

Është në fuqi ligji ekzistues për sponsorizimet, i cili parashikon rregulla të përgjithshme por të limituara për veprimtari me interes publik. Megjithatë, ky kuadër ligjor nuk vendos mekanizma të mjaftueshëm dhe të detyrueshëm për transparencë, regjistrim, deklarim dhe raportim, si dhe nuk siguron gjurmueshmëri të

plotë të burimit dhe përdorimit të fondeve, duke krijuar boshllëqe në mbikëqyrjen institucionale dhe parandalimin e ndikimeve të papërshtatshme.

Është miratuar dhe zbatuar kuadri ligjor për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, i cili përcakton parime dhe detyrime për zyrtarët publikë në lidhje me paanshmërinë, deklarimin e interesave private dhe shmangien e situatave që mund të cenojnë integritetin e vendimmarrjes. Ky kuadër ka kontribuar në adresimin e konflikteve individuale të interesit, por nuk rregullon në mënyrë të posaçme dhe të strukturuar marrëdhëniet financiare ndërmjet donatorëve, sponsorizuesve dhe institucioneve publike.

Paralelisht, janë miratuar kode etike për zyrtarët publikë, përfshirë Kodin e Etikës së anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe Kodin e Etikës së administratës publike, të cilat vendosin standarde të sjelljes, integritetit, transparencës dhe paanshmërisë në ushtrimin e detyrës, përfshirë ndërveprimet me aktorë të jashtëm. Megjithatë, këto instrumente kanë karakter të përgjithshëm dhe nuk krijojnë një regjim të posaçëm, të detajuar dhe të detyrueshëm për transparencën, regjistrimin dhe raportimin e donacioneve dhe sponsorizimeve.

Administrata publike ka ndërmarrë gjithashtu masa për rritjen e transparencës në proceset e politikëbërjes dhe menaxhimin e burimeve financiare, përmes zbatimit të legjislacionit për njoftimin dhe konsultimin publik dhe përmirësimit të praktikave të raportimit. Këto mekanizma kanë forcuar transparencën procedurale, por nuk adresojnë drejtpërdrejt dhe në mënyrë të strukturuar ndikimin e mundshëm të donacioneve dhe sponsorizimeve në vendimmarrjen publike.

Në nivel strategjik, Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030 parashikon masa parandaluese për forcimin e integritetit institucional, transparencës dhe llogaridhënies, përfshirë ndërveprimet ndërmjet sektorit publik dhe aktorëve privatë. Rregullimi i donacioneve dhe sponsorizimeve është identifikuar si pjesë e këtyre ndërhyrjeve strukturore për reduktimin e risqeve të integritetit.

Po ashtu, mekanizmat institucionalë të monitorimit dhe raportimit, përfshirë strukturat përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit në institucionet publike, si dhe bashkëpunimi me mekanizmat ndërkombëtarë të vlerësimit, kanë evidentuar nevojën për një rregullim më të qartë, të harmonizuar dhe të detyrueshëm të marrëdhënieve ndërmjet donatorëve sponsorëve dhe institucioneve publike.

Objektivi i politikës

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
2. *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
3. *Sigurohuni që objektivat janë specifikë, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Nisma synon të rrisë transparencën dhe gjurmueshmërinë e mbështetjes për veprimtaritë me interes publik. Sponsorizimet regjistrohen, pavarësisht vlerës, në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve, që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Donacionet evidentohen nga organi publik përfitues, i cili publikon informacion për çdo donacion të pranuar në Programin e Transparencës. Këto mekanizma mbështesin verifikimin e burimit dhe të përdorimit të mbështetjes së përfituar. Kjo ndërhyrje synon harmonizimin e kuadrit kombëtar me standardet e Këshillit të Evropës, OECD-së dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian.

Nisma adreson drejtpërdrejt shkaqet e identifikuara të problemit, përfshirë mungesën e një rregullimi të posaçëm dhe të detajuar ligjor për donacionet dhe sponsorizimet, mungesën e transparencës në dhënien, pranimin dhe përdorimin e tyre, si dhe mungesën e mekanizmave të qëndrueshëm të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies për aktorët publikë dhe privatë të përfshirë.

Për arritjen e objektivave të kësaj nisme, rezultatet e tyre do të maten me tregues performance agreguar në objektivët e lartpërmendr.

Objektivat specifikë të propozimit janë:

7. Vënia në funksion e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe e shërbimit elektronik përkatës brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Objektivi i përputhshmërisë është regjistrimi i të gjitha sponsorizimeve, pavarësisht vlerës, brenda afatit ligjor. Gjatë periudhës kalimtare, përmbushja e detyrimit matet mbi bazën e deklarimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
8. Publikimi nga organet publike i informacionit për të gjitha donacionet e pranuara, pavarësisht vlerës, si dhe publikimi i kontratave dhe raporteve të sponsorizimit dhe i dokumenteve për donacionet financiare, sipas rasteve dhe afateve të përcaktuara në nenet 21 dhe 24.
9. Matja veçmas e numrit dhe vlerës së sponsorizimeve, sipas kategorive të përfituesve dhe fushave të mbështetura, dhe e numrit dhe vlerës së donacioneve të evidentuara nga organet publike. Publikimi i informacionit bëhet sipas rregullave të aksesit dhe të mbrojtjes së të dhënave.
10. Forcimi i mekanizmave të verifikimit dhe kontrollit administrativ brenda 2 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit, duke arritur: rritjen me të paktën 30% të numrit të kontrolleve dhe verifikimeve administrative, krahasuar me nivelin fillestar.
11. Rritja e efektivitetit në identifikimin dhe trajtimin e shkeljeve administrative, duke siguruar: shqyrtimin 100% të rasteve të konstatuara dhe zbatimin e masave disiplinore ose sanksioneve administrative, sipas natyrës së shkeljes dhe kompetencës së autoritetit, përfshirë: mosdeklarimin, deklarimin e pasaktë, shkeljet e konfliktit të interesit, vendosjen e masave administrative për çdo rast të konstatuar.
12. Fuqizimi i rolit mbikëqyrës të autoriteteve përgjegjëse dhe rritja e zbatueshmërisë së ligjit, duke arritur: rritjen e numrit të masave administrative dhe sanksioneve të vendosura në përputhje me shkeljet e konstatuara.

Këto objektiva kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e Objektivit 1.2.5.7 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030: "*Përgatitja e ndërhyrjeve në ligj për donacionet dhe sponsorizimet dhe konsolidimi i një kuadri ligjor*" dhe garantojnë gjithashtu zbatimin e angazhimet e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës në kuadër të procesit të integrimit evropian.
Më konkretisht, treguesit do të konsistojnë në: bërjen funksionalë plotësisht të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve; deklarime dhe publikime të plota të të dhënave lidhur me donacionet e përfituara nga organet publike; transparencë dhe gjurmueshmëri e plotë; si dhe mekanizmat e kontrollit administrativ dhe të zbatimit të masave administrative të parashikuara në projektligj, plotësisht funksionale.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*

- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të përshtatshëm dhe më efikas për adresimin e problematikave të identifikuara të mungesës së një kuadri të unifikuar, transparent dhe të mbikëqyrur për donacionet dhe sponsorizimet me interes publik), janë shqyrtuar dhe vlerësuar alternativat e mundshme rregullatore, duke analizuar ndikimin, zbatueshmërinë dhe përputhshmërinë e tyre me objektivat e kësaj nisme ligjore. Opsionet janë shqyrtuar duke u bazuar në analizën e kuadrit ligjor ekzistues, dokumentin teknik paraprak, praktikat e mira ndërkombëtare, rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë, si dhe konsultimet ndërinstitucionale të zhvilluara gjatë procesit të hartimit të projektligjit.

Më konkretisht, opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0 (*status quo*): Vijimi i zbatimit të kuadrit ekzistues rregullator (ligji nr.7892/1994 "Për sponsorizimet" dhe dispozita të shpërndara në legjislacionin tatimor).
Opsioni 1 (rregullator): Ndryshime (amendime) të pjesshme në legjislacionin ekzistues për sponsorizimet dhe në ligjin tatimor.
Opsioni 2 (rregullator): Miratimi i një ligji të ri "Për Donacionet dhe Sponsorizimet".
Opsioni 3 (jorregullator): Hartimi i udhëzimeve administrative, kodeve etike dhe masave vetërregulluese institucionale.

Opsioni 0 (*status quo*): Ky opsion parashikon vijimin e zbatimit të kuadrit aktual rregullator për sponsorizimet, i cili përbëhet nga dispozita të shpërndara në legjislacionin tatimor, ligjin për organizatat jofitimprurëse, ligjin për sportin, si dhe në akte të ndryshme nënligjore që rregullojnë menaxhimin financiar në sektorin publik. Në këtë skenar, nuk do të ndërmerrej asnjë ndërhyrje e re ligjore dhe do të vijonin praktikat ekzistuese të pranimit dhe administrimit të sponsorizimeve nga institucionet publike dhe subjektet përfituese. Ky opsion nuk sjell kosto shtesë administrative apo buxhetore, por nuk adreson boshllëqet e identifikuara në transparencë, gjurmueshmëri, kontroll dhe parandalim të konfliktit të interesit apo ndikimeve të papërshtatshme në vendimmarrje.

Opsioni 1 (rregullator) - Ndërhyrje (amendime) të pjesshme në disa akte ligjore ekzistuese: Ky opsion parashikon ndërhyrje të kufizuara përmes amendimeve të pjesshme në disa akte ligjore ekzistuese, përfshirë ligjin për sponsorizimet, legjislacionin tatimor dhe dispozita të tjera sektoriale, me synim përmirësimin e disa elementeve të transparencës, raportimit apo kontrollit apo duke parashikuar edhe ndërhyrje të fragmentuara për donacionet. Megjithëse ky opsion do të kishte një shkallë më të ulët ndërhyrjeje rregullatore dhe kosto më të kufizuara administrative, ai nuk do të siguronte një rregullim të plotë dhe të unifikuar të donacioneve dhe sponsorizimeve. Fragmentarizimi normativ do të vijonte, nuk do të krijohej një mekanizëm i centralizuar regjistrimi dhe mbikëqyrjeje, dhe adresimi i risqeve të integritetit do të mbetej i pjesshëm dhe jo i qëndrueshëm.

Opsioni 2 (rregullator) - Miratimi i një ligji të ri "Për Donacionet dhe Sponsorizimet": Ky opsion parashikon hartimin dhe miratimin e një ligji të ri, të posaçëm dhe gjithëpërfshirës për donacionet dhe sponsorizimet me interes publik, i cili do të krijonte një kuadër të unifikuar ligjor për rregullimin e kësaj fushe. Ligji i ri do të përcaktonte rregullat për pranimin dhe përdorimin e donacioneve dhe sponsorizimeve, do të krijonte Regjistrin Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe do t'u kërkonte organeve publike të evidentonin donacionet e pranuara e të publikonin informacion për to. Ai do të përcaktonte edhe mekanizmat e kontrollit dhe sanksionet për shkeljet. Ky opsion adreson në mënyrë të plotë shkaqet e identifikuara të problemit dhe përputhet me objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe standardet evropiane të qeverisjes së mirë.

Opsioni 3 (jorregullator) – Hartimi i udhëzimeve administrative, kodeve etike dhe masave vetërregulluese institucionale: Ky opsion parashikon përdorimin e instrumenteve joligjore, si udhëzime administrative, kode etike, praktika vetërregulluese apo marrëveshje vullnetare për rritjen e transparencës në donacionet dhe sponsorizimet, apo edhe rritje të kontrolleve dhe inspektimeve nga autoritetet përgjegjëse. Megjithëse ky opsion do të kishte kosto të ulëta dhe fleksibilitet më të madh, ai nuk do të krijonte detyrime ligjore të zbatueshme, nuk do të siguronte regjistrim të detyrueshëm dhe nuk do të garantonte mbikëqyrje efektive dhe sanksionim në rast shkeljesh. Si i tillë, ky opsion vlerësohet i pamjaftueshëm për adresimin e risqeve të identifikuara të integritetit dhe ndikimeve të papërshtatshme në vendimmarrjen publike.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
    - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
    - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
    - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
    - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
    - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
    - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
    - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
    - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmblidhni vlerësimin e opsioneve:*
    - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
    - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
    - *Paraqisni përllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura

Në zbatimin e projektligjit "Për Donacionet dhe Sponsorizimet" identifikohen këto grupe kryesore të prekura:

Institucionet publike (qendrore dhe vendore): Institucionet publike do të preken drejtpërdrejt nga zbatimi i projektligjit, pasi do të duhet të përshtasin procedurat e tyre të brendshme për pranimin, administrimin, raportimin dhe regjistrimin e donacioneve dhe sponsorizimeve, në përputhje me kërkesat e reja ligjore. Kjo nënkupton rritje të përkohshme të barrës administrative, nevojë për forcim kapacitetesh teknike dhe organizative, si dhe përshtatje të sistemeve ekzistuese të administrimit. Megjithatë, në afatmesëm dhe afatgjatë, nisma pritet të krijojë standarde të unifikuara që rrisin transparencën, gjurmueshmërinë dhe llogaridhënien, duke forcuar integritetin institucional dhe besimin publik.

Sektori privat (bizneset dhe subjektet sponsorizuese dhe donatorë): Subjektet private që ofrojnë donacione ose sponsorizime do të ndikohen nga vendosja e detyrimeve të reja për dokumentim, deklarim dhe raportim të marrëdhënieve financiare në përputhje me kuadrin e ri ligjor. Këto kërkesa mund të sjellin një rritje të moderuar të barrës administrative, veçanërisht në lidhje me dokumentimin e burimit të fondeve dhe respektimin e afateve procedurale. Nga ana tjetër, projektligji krijon një mjedis më të qartë dhe më të parashikueshëm juridik, redukton pasiguritë ekzistuese dhe forcon legjitimitetin e kontributit financiar privat në aktivitete me interes publik.

Organizatat jofitimprurëse dhe organizatat sportive: Përfituesit e sponsorizimeve sipas nenit 4, pika 5, janë organizatat jofitimprurëse, organizatat dhe shoqëritë sportive, subjektet tregtare në prodhimin e filmit dhe në industrinë audiovizive, botuesit e shtypit dhe të veprave letrare, shkencore e enciklopedike, si dhe individët që përfaqësojnë Shqipërinë në aktivitete ndërkombëtare në art, sport ose kulturë. Ndikimi mbi këto subjekte lidhet me dokumentimin, regjistrimin dhe raportimin e sponsorizimeve. Përfituesit e donacioneve sipas këtij projektligji janë organet publike, të cilat mund të përfitojnë edhe sponsorizime.

Autoritetet mbikëqyrëse dhe institucionet e kontrollit: Autoritetet përgjegjëse për kontrollin financiar, fiskal, antikorrupsion dhe parandalimin e pastrimit të parave do të ndikohen nga zbatimi i projektligjit përmes krijimit të një kuadri më të strukturuar për regjistrimin, raportimin dhe aksesin në informacionin mbi donacionet dhe sponsorizimet. Zbatimi i mekanizmave të rinj mund të kërkojë përshtatjen e procedurave të kontrollit dhe koordinimit ndërinstitucional, si dhe forcimin e kapaciteteve për përdorimin dhe analizimin e të dhënave të disponueshme. Mbledhja dhe administrimi i informacionit të konsoliduar dhe të gjurmueshëm pritet të përmirësojë kapacitetet për monitorim dhe analizë risku, të lehtësojë identifikimin e parregullsive dhe situatave me risk, si dhe të forcojë efektivitetin e mekanizmave të kontrollit dhe parandalimit.

Ndikimet e drejtpërdrejta

Zbatimi i projektligjit pritet të sjellë ndikime të drejtpërdrejta me natyrë administrative dhe institucionale, financiare, ekonomike, sociale, si dhe në drejtim të qeverisjes dhe forcimit të mekanizmave parandalues. Këto ndikime lidhen kryesisht me vendosjen e standardeve të unifikuara për pranimin, administrimin, dokumentimin, raportimin dhe regjistrimin e donacioneve dhe sponsorizimeve, si dhe me krijimin dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Donacioneve dhe Sponsorizimeve.

Ndikime administrative dhe institucionale

Për organet publike, ndikimi administrativ përfshin verifikimin e kufizimeve ligjore dhe konfliktit të interesit, evidentimin e publikimin e donacioneve të pranuara, si dhe regjistrimin dhe raportimin elektronik të sponsorizimeve sipas neneve 10, 11 dhe 21. Kur është e mundur teknikisht dhe ligjërisht, të dhënat zyrtare

për verifikim sigurohen përmes ndërveprimit elektronik dhe nuk kërkohen sërish nga donatori ose sponsorizuesi (neni 9).

Për sponsorizimet në favor të organizatave jofitimprurëse, kur vlera e përgjithshme e dhënë nga i njëjti sponsorizues për të njëjtin përfitues gjatë një viti kalendarik nuk tejkalon 300 000 lekë, neni 9, pika 2, parashikon dokument identifikimi ose regjistrimi dhe vetëdeklarim për përmbushjen e kushteve të nenit 7 dhe mungesën e konfliktit të interesave. Ky lehtësim dokumentar nuk përjashton detyrimin për regjistrimin elektronik të sponsorizimit, pavarësisht vlerës (neni 10, pika 6).

Autoritetet mbikëqyrëse dhe institucionet e kontrollit do të duhet gjithashtu të përshtatin, sipas kompetencave të tyre, procedurat e monitorimit, verifikimit dhe analizimit të informacionit të disponueshëm, duke kërkuar forcim të kapaciteteve teknike dhe organizative për përdorimin efektiv të të dhënave të regjistruara.

Ndikime financiare dhe buxhetore

Projektligji mund të sjellë kosto financiare dhe administrative, veçanërisht në fazën e vitit të parë të zbatimit të tij. Për institucionet publike, kostot kryesore lidhen me krijimin, vënien në funksion dhe mirëmbajtjen e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve, si dhe me ngritjen e kapaciteteve administrative dhe teknike të nevojshme për funksionimin e tij.

Përveç vlerave paraprake të paraqitura në analizën e kostove, ndikimi financiar përfundimtar i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve varet nga specifikimet teknike, kapacitetet ekzistuese të DPT-së dhe AKSHI-t, ndërveprimi me bazat e tjera shtetërore, masat e sigurisë kibernetike, mbrojtja e të dhënave dhe shpenzimet për mirëmbajtjen. Këto elemente kërkojnë vlerësim dhe konfirmim institucional.

Për institucionet e tjera publike, zbatimi mund të krijojë gjithashtu kosto të kufizuara administrative të lidhura me përshtatjen e procedurave dhe ngritjen e kapaciteteve. Shkalla konkrete e këtyre kostove do të varet nga kapacitetet dhe sistemet ekzistuese të secilit institucion.

Ndikime ekonomike

Për subjektet private që japin donacione ose sponsorizime, projektligji vendos kërkesa më të strukturuara për dokumentimin dhe deklarimin e marrëdhënieve përkatëse, përfshirë kërkesat që lidhen me burimin e fondeve, dokumentacionin shoqërues, kriteret për përfitimin e lehtësive tatimore dhe respektimin e afateve procedurale.

Këto kërkesa mund të sjellin një rritje të moderuar të barrës administrative për subjektet sponsorizuese dhe donatore, kryesisht në lidhje me dokumentimin dhe raportimin. Megjithatë, nuk vlerësohet se zbatimi i projektligjit do të kërkojë shtim të personelit apo ndryshime të konsiderueshme organizative për bizneset, pasi detyrimet e reja lidhen kryesisht me procese administrative dhe financiare që këto subjekte kryejnë në kuadër të aktivitetit të tyre.

Nga ana tjetër, përcaktimi më i qartë i rregullave dhe procedurave për donacionet dhe sponsorizimet pritet të rrisë sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë për subjektet private dhe përfituesit e tyre, duke reduktuar paqartësitë në administrimin e këtyre marrëdhënieve.

Ndikime sociale dhe në besimin publik

Standardizimi i procedurave dhe rritja e transparencës mbi burimin, përfituesin dhe përdorimin e donacioneve dhe sponsorizimeve pritet të ndikojnë pozitivisht në besimin e publikut ndaj mënyrës së

administrimit të këtyre fondeve, veçanërisht kur ato lidhen me institucione publike ose me veprimtari me interes publik.

Për subjektet përfituese, kërkesat për dokumentim dhe raportim më të plotë krijojnë mundësi për të demonstruar në mënyrë më të qartë dhe të verifikueshme përdorimin e fondeve për qëllimet e përcaktuara. Në këtë mënyrë, kuadri i ri pritet të kontribuojë në forcimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe besueshmërisë së marrëdhënieve të donacionit dhe sponsorizimit.

Ndikime në qeverisje dhe parandalimin e korrupsionit

Një nga ndikimet kryesore të drejtpërdrejta të projektligjit lidhet me forcimin e transparencës, gjurmueshmërisë dhe llogaridhënies në administrimin e donacioneve dhe sponsorizimeve. Vendosja e standardeve të unifikuara për dokumentimin dhe raportimin, së bashku me krijimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar, pritet të krijojë një bazë më të strukturuar informacioni për monitorimin dhe kontrollin e këtyre marrëdhënieve.

Pasja dhe administrimi i të dhënave më të plota dhe të konsoliduara pritet të mbështesë autoritetet përgjegjëse, sipas kompetencave përkatëse, në identifikimin e parregullsive dhe situatave me risk, përfshirë risqet që lidhen me konfliktin e interesit dhe përdorimin jo të rregullt të donacioneve dhe sponsorizimeve. Në këtë mënyrë, projektligji pritet të forcojë mekanizmat parandalues dhe të kontrollit, si dhe integritetin dhe llogaridhënien në marrëdhëniet ndërmjet donatorëve, sponsorëve, përfituesve dhe institucioneve publike.

Ndikimet jo të drejtpërdrejta

Përvec efekteve të drejtpërdrejta që lidhen me zbatimin e detyrimeve të reja ligjore, projektligji pritet të gjenerojë ndikime më të gjera në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Këto ndikime lidhen me konsolidimin e praktikave institucionale, rritjen e besueshmërisë së marrëdhënieve të donacionit dhe sponsorizimit, forcimin e besimit publik dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për integritetin dhe llogaridhënien.

Në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, standardizimi i procedurave për pranimin, administrimin, raportimin dhe regjistrimin e donacioneve dhe sponsorizimeve pritet të kontribuojë në konsolidimin e praktikave administrative të institucioneve dhe në reduktimin e mënyrave të ndryshme të trajtimit të këtyre marrëdhënieve. Përdorimi sistematik i regjistrit elektronik dhe krijimi i një baze të konsoliduar informacioni pritet të përmirësojnë koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, si dhe të mbështesin një ushtrim më të strukturuar të funksioneve të monitorimit dhe kontrollit.

Ndikime financiare dhe ekonomike

Për sektorin privat, një kuadër ligjor më i qartë dhe i parashikueshëm pritet të krijojë kushte më të sigurta për ofrimin e donacioneve dhe sponsorizimeve dhe të reduktojë pasiguritë që lidhen me zbatimin e rregullave përkatëse. Në afat më të gjatë, transparenca dhe standardizimi i këtyre marrëdhënieve mund të kontribuojnë në rritjen e besueshmërisë së mbështetjes financiare private për veprimtari me interes publik dhe në krijimin e kushteve më të qëndrueshme për zhvillimin e tyre.

Për organizatat jofitimprurëse, organizatat sportive dhe subjektet që operojnë në fushën e artit dhe kulturës, rritja e transparencës dhe e besueshmërisë në administrimin e fondeve të përfituara mund të ndikojë pozitivisht në marrëdhëniet me donatorët dhe sponsorët dhe, në perspektivë, në qëndrueshmërinë e mbështetjes financiare për veprimtaritë e tyre.

Ndikime sociale dhe në besimin publik

Një ndikim i rëndësishëm i pritshëm lidhet me rritjen e besimit të publikut në mënyrën se si administrohen donacionet dhe sponsorizimet, veçanërisht në marrëdhëniet ku përfshihen institucionet publike ose fondet që mbështesin veprimtari me interes publik. Rritja e transparencës mbi burimin, përfituesin dhe qëllimin e përdorimit të fondeve pritet të krijojë mundësi më të mëdha për informim dhe mbikëqyrje publike.

Në një perspektivë më të gjerë, zbatimi i qëndrueshëm i standardeve të transparencës dhe raportimit mund të kontribuojë në konsolidimin e një kulture të përgjegjshmërisë, integritetit dhe llogaridhënies në marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike, sektorit privat, organizatave përfituese dhe qytetarëve.

Ndikime në qeverisje dhe parandalimin e korrupsionit

Në nivel sistemik, krijimi i një kuadri të unifikuar dhe transparent për donacionet dhe sponsorizimet pritet të kontribuojë në reduktimin e hapësirave për konflikt interesi, ndikim të papërshtatshëm dhe përdorim jo transparent të fondeve. Disponueshmëria në vijimësi e të dhënave të strukturuara mund të krijojë gjithashtu një bazë më të mirë për identifikimin e tendencave dhe risqeve dhe për zhvillimin e analizave të bazuara në të dhëna nga institucionet kompetente.

Analiza e kostos dhe e përfitimeve

Analiza e kostos dhe përfitimeve të projektligjit "Për Donacionet dhe Sponsorizimet" është realizuar duke marrë në konsideratë natyrën rregullatore të nismës, faktin që ligji krijon një kuadër të ri të posaçëm ligjor dhe institucional, si dhe nevojën për të aplikuar parimin e proporcionalitetit në vlerësimin e ndikimeve.

Kostot e parashikuara

<u>Kostot administrative dhe institucionale</u> lidhen kryesisht me:

- Krijimin dhe vënien në funksion të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve

Për ngritjen e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve, RIA paraqet një vlerësim fillestar prej 6 000 000 lekësh në vitin 2027 dhe mirëmbajtje prej 900 000 lekësh në vit nga viti 2028. Këto vlera janë supozime të analizës financiare dhe kërkojnë konfirmim nga institucionet përgjegjëse për zhvillimin, ndërveprimin, sigurinë kibernetike dhe funksionimin e sistemit elektronik.

- Punonjës që do merren me kompetencat përkatëse

Ky ligj sjell detyrime të reja për institucionin dhe parashikohet punësimi i 2 punonjësve të rinj që do jenë specialistë dhe do të mbulojnë funksione mbështetëse si organizimi i trajnimeve dhe fushatave sensibilizuese, verifikimi i dokumentacionit të kërkuar dhe zbatimit të sponsorizimit apo donacionit. Pra ata do jenë përgjegjës për mbikëqyrjen, kontrollin dhe verifikimin e veprimtarive të sponsorizimit dhe donacionit, zbatimin e detyrimeve ligjore dhe kryerjen e funksioneve administrative të nevojshme për zbatimin e këtij ligji. Shpenzimet e lidhura me punësimin e tyre janë:

1. Shpenzimet shtesë përfshijnë pagat dhe kontributet e punëdhënësit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për dy punonjës të kategorisë IV-1. Duke përdorur si bazë vjetore shumën prej 3.164,904 lekësh për vitin 2026 dhe një indeksim vjetor prej 3%, kostoja e parashikuar është 3.259,851 lekë në vitin 2027 dhe 3.357,647 lekë në vitin 2028, ose 6.617,498 lekë për të dy vitet.

Shpenzimet shtesë lidhen me fondin vjetor të pagave dhe sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore nga punëdhënësi, për 2 punonjësit të kategorisë IV-1. Shpenzimet parashikohet të fillojnë në 2027 pasi nuk ka parashikim të tyre në PBA 2027-2029 dhe për rrjedhojë ata do parashikohen në PBA 2028 - 2030. Pagesa për paga dhe sigurime shëndetësore e shoqërore për vitin 2026 kap vlerën 3.164.904 lekë, duke marrë parasysh politikën e indeksimit të pagave dhe duke parashikuar që norma e indeksimit do jetë 3% në vitet

2027-2030, kostot vjetore shtesë për paga për punonjësit do jenë respektivisht **3,357,647 lekë në 2027, 3,458,376 lekë në 2028**. Kosto shtesë në paga dhe sigurime shoqërore parashikohet të jetë **6,816,023 lekë për të dy vitet**.

2. Supozohet se hapësira e punës (pajisje mobilimi /tavolinë/karrige/PC/Laptop/printer etj) do ketë një kosto prej rreth 200.000 lekë për person me një **kosto totale në 400.000 lekë** për të 2 punonjësit. Këto shpenzime nuk janë pjesë e PBA 2027-2029, por mund të parashikohen në PBA 2028 – 2030 dhe efekti financiar do të parashikohet në vitin 2027.

3. Shpenzime operative të domosdoshme ku do të përfshihen fushatat sensibilizuese/aktivitete mbi ligjin për rritje të ndërgjegjësimit te nëpunësve publike apo subjekteve të përcaktuara nga ligji që mund të jenë sponsor ose donator potencial, në të gjithë territorin, e cila do të kapë nje vlerë rreth **500.000 lekë për secilin vit (2027-2028)**.

Ndikimi i lehtësive tatimore të parashikuara në nenet 14 dhe 15 të projektligjit mbi të ardhurat e buxhetit të shtetit nuk mund të përllogaritet në këtë fazë, për shkak të mungesës së të dhënave.

Aktualisht nuk është parashikuar mbështetje nga donatorët.

Këto kosto janë **të kufizuara dhe të menaxhueshme**, pasi zbatimi i ligjit mbështetet në struktura ekzistuese institucionale dhe nuk kërkon krijimin e një institucioni të ri të pavarur. Shumica e kostove që vijnë për buxhetin e shtetit, si pasojë e këtij ligji janë kosto shtesë.

Kostot për subjektet që përfitojnë nga donacionet apo sponsorizimet lidhen me:

- përgatitjen e dokumentacionit
- përgatitjen e raporteve
- përshtatjen e praktikave të brendshme administrative për respektimin e kërkesave ligjore.

Këto kosto janë të natyrës administrative dhe konsiderohen proporcionale me objektivin e transparencës, pa krijuar barriera të pajustifikuara. Kostot për këto subjekte nuk mund të llogariten pasi nuk ka të dhëna historike.

Përfitimet e parashikuara

Në mungesë të të dhënave të plota, përfitimet e pritshme nga rritja e transparencës, gjurmueshmërisë dhe kontrollit nuk mund të monetizohen me besueshmëri në këtë fazë. Vlerat e donacioneve të pranuara nga organet publike nuk përbëjnë automatikisht përfitim neto të shkaktuar nga rregullimi i ri; edhe të ardhurat eventuale nga sanksionet administrative nuk mund të trajtohen si përfitim i garantuar. Vlerësimi sasior duhet të plotësohet pas sigurimit të të dhënave përkatëse.

Nga analiza cilësore priten përfitime afatmesme dhe afatgjata në transparencë dhe integritet; megjithatë, pa monetizimin e tyre nuk mund të provohet në terma sasiorë se përfitimet neto tejkalojnë kostot e zbatimit. Zgjedhja e opsionit 2 mbështetet kryesisht në analizën cilësore dhe shumëkriterëshe, ndërsa raporti monetar kosto-përfitim mbetet për t'u plotësuar sipas të dhënave financiare të verifikuara.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Bazuar në analizën e problemit, shkaqeve të tij, shtrirjes, grupeve të prekura si dhe vlerësimin krahasues të opsioneve të politikave, opsioni i preferuar është Opsioni 2: miratimi i një ligji të ri "Për Donacionet dhe Sponsorizimet".

Ky opsion përfaqëson zgjidhjen më të plotë, koherente dhe të qëndrueshme për adresimin e problematikës së identifikuar, pasi krijon për herë të parë një kuadër të unifikuar, të posaçëm dhe detyrues ligjor për rregullimin e donacioneve dhe sponsorizimeve me interes publik, duke dalluar qartë ndërmjet:

- donacioneve dhe sponsorizimeve ndaj organeve publike,
- sponsorizimeve ndaj subjekteve të përcaktuara në nenin 4, pika 5, të projektligjit.

Status quo-ja e cila identifikon Opsionin 0, nuk adreson boshllëqet ekzistuese në transparencë, gjurmueshmëri dhe kontroll, duke lënë në fuqi një kuadër të fragmentuar, të vjetëruar dhe të paunifikuar, i cili nuk garanton parandalimin e konfliktit të interesit, ndikimeve të papërshtatshme apo përdorimit jo transparent të fondeve.

Ndryshimet e pjesshme në legjislacionin ekzistues (Opsioni 1) do të sillnin po ashtu ndërhyrje të kufizuara dhe të shpërndara, duke ruajtur fragmentarizimin normativ dhe duke mos krijuar mekanizma të qëndrueshëm për regjistrim të detyrueshëm, raportim publik dhe monitorim efektiv në nivel kombëtar.

Opsioni jorregullator (Opsioni 3), përmes udhëzimeve apo instrumenteve vetërregulluese, nuk siguron detyrim ligjor, nuk krijon mekanizma sanksionues dhe nuk garanton transparencë të unifikuar dhe të verifikueshme, duke qenë i pamjaftueshëm për të adresuar risqet e identifikuara të integritetit dhe korrupsionit.

Opsioni 2 parashikon krijimin e bazës së të dhënave shtetërore "Regjistri Elektronik Kombëtar i Sponsorizimeve", me deklarim në e-Albania, administrim nga DPT-ja dhe ndërveprim elektronik me regjistrat shtetërorë, sipas nenit 10 dhe evidentimin e publikimin e donacioneve nga organet publike. Këto mekanizma lehtësojnë monitorimin dhe kontrollin dhe ndihmojnë në identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe të përdorimit të papërshtatshëm të mbështetjes.

Në këtë kuptim, Opsioni 2 vlerësohet si opsioni që adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë shkaqet themelore të problemit, përputhet me objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024 - 2030 dhe mbështet prioritetet e qeverisë për forcimin e sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë.

Kriteret e përdorura në këtë analizë përmenden:

Analiza shumëkriterëshe mbështetet në kriteret e mëposhtme:

1- Efektiviteti në adresimin e problemit, duke vlerësuar shkallën në të cilën secili opsion adreson shkaqet themelore të problematikës së identifikuar, përfshirë mungesën e një kuadri të unifikuar, transparencës së detyrueshme dhe mekanizmave të qëndrueshëm të monitorimit.
2- Koherenca dhe unifikimi normativ, duke vlerësuar mundësinë e krijimit të një kuadri të qartë, të integruar dhe jo të fragmentuar ligjor, që shmang mbivendosjet, boshllëqet dhe interpretimet e ndryshme administrative.
3- Ndikimi në transparencë dhe integritet institucional, duke vlerësuar kontributin e secilit opsion në rritjen e gjurmueshmërisë së fondeve, publikimin sistematik të informacionit, parandalimin e konfliktit të interesit dhe reduktimin e risqeve të ndikimeve të papërshtatshme dhe praktikave korruptive.
4- Përputhshmëria me prioritetet strategjike dhe angazhimet ndërkombëtare të vendit, duke vlerësuar shkallën në të cilën secili opsion kontribuon në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër

Korrupsionit 2024-2030, Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës dhe standardeve përkatëse të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe OECD-së.

5- Proporcionaliteti dhe kosto-efektiviteti, duke vlerësuar nëse kostot administrative, financiare dhe institucionale që lidhen me zbatimin e secilit opsion janë proporcionale me rezultatet dhe përfitimet e pritshme.

Për të mundësuar një krahasim të strukturuar ndërmjet alternativave, secili prej katër opsioneve është vlerësuar kundrejt kritereve të mësipërme, duke përdorur një shkallë vlerësimi nga 1 deri në 5, ku: 1 = përmbushje shumë e ulët e kriterit; 2 = përmbushje e ulët; 3 = përmbushje mesatare; 4 = përmbushje e lartë; dhe 5 = përmbushje shumë e lartë. Vlerësimi pasqyron shkallën në të cilën secili opsion adreson kriterin përkatës, duke marrë në konsideratë njëkohësisht përfitimet e pritshme dhe kostot apo kufizimet e mundshme të zbatimit.

Më konkretisht, nga vlerësimi i secilit prej opsioneve kundrejt kritereve të përcaktuara më sipër, rezulton një diferencë e qartë ndërmjet alternativave të shqyrtuara. Rezultatet e analizës shumëkriterëshe tregojnë një diferencë të qartë ndërmjet alternativave të shqyrtuara. Opsioni 0 paraqet nivelin më të ulët të përmbushjes së kritereve, pasi ruajtja e status quo-së nuk adreson problematikat e identifikuara në kuadrin aktual. Opsioni 1 mundëson adresimin e pjesshëm të tyre, por ruan fragmentarizimin e kuadrit normativ dhe kufizon mundësinë e krijimit të një sistemi të unifikuar të transparencës dhe monitorimit. Opsioni 3 paraqet kosto dhe kërkesa më të kufizuara për zbatim, por mungesa e karakterit detyrues kufizon efektivitetin e tij në adresimin e problematikës.

Në vlerësimin kundrejt të njëjtave kritere, Opsioni 2 rezulton si alternativa me vlerësimin më të lartë, pasi siguron nivelin më të lartë të efektivitetit, koherencës normative, transparencës dhe integritetit institucional, si dhe përputhshmërisë me prioritetet strategjike. Në kriterin e proporcionalitetit dhe kosto-efektivitetit, ky opsion vlerësohet me 4 pikë, duke marrë në konsideratë kostot fillestare administrative dhe financiare që lidhen veçanërisht me krijimin dhe funksionimin e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve. Megjithatë, këto kosto vlerësohen proporcionale me përfitimet e pritshme afatmesme dhe afatgjata të kuadrit të ri. Në përfundim, analiza shumëkriterëshe mbështet përzgjedhjen e Opsionit 2 si alternativa më e përshtatshme për arritjen e objektivave të politikës.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Struktura përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur:

Autoriteti kompetent i përcaktuar në këtë nismë ligjore është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për administrimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Ky autoritet do të ketë kompetenca për krijimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Donacioneve dhe Sponsorizimeve, verifikimin e përputhshmërisë së donacioneve dhe sponsorizimeve me legjislacionin tatimor, dhe administrimin e lehtësive tatimore të parashikuara nga ligji, në bazë të të dhënave të regjistruara dhe dokumentacionit shoqërues.

Për sponsorizimet në art, kulturë dhe sport, ministria përgjegjëse për këto fusha, me kërkesë të përfituesit dhe përpara lidhjes së kontratës, lëshon brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës së plotë vërtetimin se veprimtaria zhvillohet në fushën përkatëse dhe përbën veprimtari me interes publik. Vlerësimi për përfitimin e lehtësisë tatimore kryhet veçmas, sipas kushteve ligjore.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve administron bazën e të dhënave shtetërore "Regjistri Elektronik Kombëtar i Sponsorizimeve", në bashkëpunim me AKSHI-n për krijimin dhe vënien në funksion të saj. Deklarimi dhe regjistrimi i sponsorizimeve, pavarësisht vlerës, kryhen nga përfituesit përmes shërbimit elektronik në e-Albania brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kontratës (neni 10). Ndryshimet e kontratës përditësohen sipas nenit 11, brenda 30 ditëve. Organi publik publikon kontratat dhe raportet e sponsorizimeve sipas nenit 21 dhe evidenton e publikon donacionet sipas nenit 24. Gjatë periudhës kalimtare, sponsorizimet deklarohen pranë DPT-së, ndërsa të dhënat e përkohshme transferohen në Regjistër brenda 90 ditëve nga vënia në funksion, pa kërkuar ridorëzimin e tyre (neni 30).

Për sponsorizimet në art, kulturë dhe sport, ministria përgjegjëse për këto fusha, me kërkesë të përfituesit dhe përpara lidhjes së kontratës, lëshon brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës së plotë vërtetimin se veprimtaria zhvillohet në fushën përkatëse dhe përbën veprimtari me interes publik. Përfitimi i lehtësisë tatimore vlerësohet veçmas, sipas kushteve ligjore.

Organet publike publikojnë kontratat e sponsorizimit brenda 10 ditëve nga nënshkrimi dhe raportet e zbatimit sipas nenit 21. Për donacionet që pranojnë, ato evidentojnë dhe publikojnë informacionin sipas nenit 24. Organet ligjzbatuese dhe agjencitë e inteligjencës kanë akses në Regjistër sipas kompetencave të tyre. Agjencia e Inteligjencës Financiare ka gjithashtu akses në dokumentacionin e përcaktuar në nenin 17.

Pengesat e mundshme në zbatim

Zbatimi efektiv i ligjit mund të përballet me disa sfida fillestare, të cilat kërkojnë adresim përmes masave paraprake dhe planifikimit të kujdesshëm:

Së pari, një pengesë e mundshme lidhet me kapacitetet administrative dhe teknike për krijimin dhe funksionimin efektiv të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve, përfshirë zhvillimin e sistemit IT, integrimin me sistemet ekzistuese dhe trajnimin e stafit për përdorimin dhe administrimin e tij.

Së dyti, në fazën fillestare, përfituesit mund të hasin vështirësi në regjistrimin e sponsorizimeve brenda afateve. Për organet publike, një vështirësi shtesë mund të jetë përshtatja e procedurave të brendshme për evidentimin dhe publikimin e donacioneve të pranuara.

Së treti, fragmentarizimi i praktikave ekzistuese dhe mungesa e standardeve të harmonizuara ndërinstitucionale mund të sjellë interpretim të ndryshëm të dispozitave ligjore, veçanërisht në lidhje me kriteret për interes publik, kufizimet ligjore dhe procedurat e verifikimit.

Së katërti, zbatimi efektiv i ligjit kërkon bashkëpunim të qëndrueshëm ndërinstitucional ndërmjet autoriteteve tatimore, institucioneve sektoriale, strukturave antikorrupsion dhe autoriteteve ligjzbatuese. Mungesa e koordinimit ose e shkëmbimit të rregullt të informacionit mund të ndikojë në efektivitetin e monitorimit dhe kontrollit.

Masat e parashikuara gjatë zbatimit

Për të siguruar funksionimin efektiv të ligjit, parashikohen këto masa mbështetëse:

Së pari, do të miratohen në kohë aktet nënligjore përkatëse, të cilat do të detajojnë procedurat e regjistrimit, raportimit, verifikimit dhe kontrollit të donacioneve dhe sponsorizimeve.

Së dyti, DPT-ja, në bashkëpunim me AKSHI-n dhe institucionet e tjera përgjegjëse, merr masat për krijimin dhe vënien në funksion të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve dhe shërbimit përkatës në e-Albania brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit (neni 30). Deri në aktivizim, përfituesit deklarojnë sponsorizimet pranë DPT-së sipas formularit të publikuar prej saj. Të dhënat kalimtare transferohen brenda 90 ditëve në Regjistër dhe sanksionet për mosregjistrimin elektronik nuk zbatohen për periudhën gjatë së cilës shërbimi nuk është funksional.

Së treti, do të forcohet bashkëpunimi ndërinstitucional, përmes vendosjes së mekanizmave të rregullt të shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve tatimore, institucioneve përgjegjëse sipas fushës, strukturave antikorrupsion dhe autoriteteve ligjzbatuese, për të rritur efektivitetin e monitorimit dhe kontrollit.

Së katërti, do të organizohen fushata informuese dhe aktivitete ndërgjegjësuese për institucionet publike, organizatat jofitimprurëse, bizneset dhe aktorët e tjerë privatë, me qëllim sqarimin e detyrimeve ligjore, përfitimeve nga rregullimi i ri dhe pasojave të moszbatimit të tij.

Së fundi, nga të dhënat e zbatimit të ligjit do të përdoren si bazë për rishikime të mëvonshme të kuadrit rregullator, nëse do të jetë e nevojshme, duke garantuar që politika të mbetet e përshtatshme, efektive dhe e harmonizuar me zhvillimet ligjore dhe praktikat më të mira evropiane.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi i zbatimit të ligjit do të kryhet nga autoriteti përgjegjës, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, dhe do të pasqyrohet në raporte periodike. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit "Për Donacionet dhe Sponsorizimet" do të realizohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar, me qëllim matjen e progresit drejt arritjes së objektivave të politikës, identifikimin e problematikave në zbatim dhe përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator dhe praktikave administrative.

Matja e arritjes së objektivave të nismës ligjore dhe progresit të zbatimit të ligjit do të bazohet në tregues cilësorë dhe sasiorë, përfshirë:

Tregues sasiorë janë:

1. **Numri dhe vlera e sponsorizimeve të deklaruara pranë DPT-së gjatë periudhës kalimtare ose të regjistruara pas vënies në funksion të shërbimit elektronik**, sipas llojit të përfituesit, sektorit të mbështetur dhe vlerës financiare.

Trend i synuar: rritje graduale e numrit të regjistrimeve dhe konsolidim i të dhënave në vitet e para të zbatimit, me stabilizim në vijim.

2. **Përqindja e sponsorizimeve të regjistruara brenda afatit dhe përqindja e raporteve të sponsorizimit të dorëzuara brenda afatit,** në raport me totalin.

Trend i synuar: rritje e vazhdueshme drejt 100% respektimit të afateve.

3. **Numri dhe vlera e donacioneve të evidentuara nga organet publike dhe përqindja e donacioneve për të cilat është publikuar informacioni i kërkuar.**

Trend i synuar: rritje progresive deri në arritjen e mbulimit të plotë (100%) në afat mesatar.

4. **Përqindja e kontratave dhe raporteve të sponsorizimit të publikuara sipas nenit 21 dhe përqindja e publikimeve për donacionet financiare të kryera brenda afateve të posaçme të nenit 24.**

Trend i synuar: rritje e kapacitetit të kontrollit dhe mbulim më i lartë i rasteve me risk.

5. **Përqindja e rasteve të konstatimit të shkeljeve në raport me numrin total të subjekteve të kontrolluara.**

Trend i synuar: ulje progresive e përqindjes së shkeljeve në kohë, si tregues i përmirësimit të përputhshmërisë ligjore.

6. **Përqindja e masave administrative/sanksioneve të vendosura në raport me numrin e shkeljeve të konstatuara.**

Trend i synuar: rritje e konsistencës së zbatimit të sanksioneve (drejt 100% të rasteve të shkeljeve të adresuara).

7. **Vlera totale e donacioneve dhe sponsorizimeve të raportuara në nivel kombëtar.**

Trend i synuar: rritje graduale e formalizimit të financimeve dhe rritje e vlerës së raportuar përmes kanaleve zyrtare.

Tregues cilësorë janë:

1. **Niveli i cilësisë së të dhënave në Regjistër (aksesueshmëria, standardizimi, saktësia dhe qartësia e informacionit).**

Trend i synuar: përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë dhe përdorshmërisë së të dhënave.

2. **Niveli i përputhshmërisë së praktikave institucionale me rregullat për konfliktin e interesit dhe transparencën, bazuar në analizën e rasteve të kontrolluara**.

Trend i synuar: rritje e përputhshmërisë dhe ulje e mosdeklarimeve.

3. **Përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional në monitorim dhe verifikim.**

Trend i synuar: forcim progresiv i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të të dhënave.

4. **Niveli i kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimit, i matur përmes:** numrit të trajnimeve, pjesëmarrjes institucionale, dhe *feedback*-ut të aktorëve të interesuar.

Trend i synuar: rritje e kapaciteteve dhe pjesëmarrjes në mënyrë të rregullt.

5. Vlerësimi i ndikimit të ligjit në reduktimin e risqeve të konfliktit të interesit dhe ndikimeve të papërshtatshme.

Trend i synuar: ulje progresive e risqeve të identifikuara në analizat periodike të institucioneve.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Aktualisht mund të llogariten kostot për buxhetin e shtetit vetëm përsa i përket burimeve njerëzore dhe ngritjes së Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve. Këto kosto prekin drejtpërdrejtë buxhetin e Drejtorisë së Tatimeve dhe Ministrisë së Financave.
Kosto të vazhdueshme lidhen me (i) fondin e pagave për 2 punonjës shtesë (në këtë fond është reflektuar politika e indeksimit të pagave që qeveria ka filluar në vitin 2026), (ii) Shpenzime operative të domosdoshme ku do të përfshihen fushatat sensibilizuese/aktivitete mbi ligjin për rritje të ndërgjegjësimit te nëpunësve publike mbi subjektet e përcaktuara nga ligji që mund të jenë sponsor ose donator potencial që fillojnë në 2027, dhe (iii) fondi i mirëmbajtjes së regjistrit (që fillon në vitin 2028). Për shpenzimet operative dhe shpenzimet e mirëmbajtjes është mbajtur e njëjtë vlera nominale, pa u indeksuar, për të gjitha vitet pasardhëse të viteve 2027 dhe 2028. Rritja e shpenzimeve vit pas viti, në këtë skenar vjen si pasojë e politikës së indeksimit të pagave.
Kosto vetëm një herë janë parashikuar në vitin 2027 dhe janë (i) krijimi i hapësirës së punës për 2 punonjësit dhe (ii) ngritja e Regjistrit Elektronik Kombëtar të Sponsorizimeve.

Përsa i përket përfitimeve me vlerë monetare, siç është shpjeguar edhe më lart, nuk është e mundur që të bëhet një parashikim afatgjatë pasi nuk ka të dhëna historike dhe baza e llogaritjes ka të bëjë me fitimin e sponsorizuesve. Gjithashtu, vendosja e sanksioneve administrative është një risi i ligjit dhe pamundëson llogaritjen e të ardhurave që mund të gjenerohen.

Si konkluzion, mund të shtojmë që për këto arsye si lartpërmendur, analiza mund të bëhet vetëm për shpenzimet e buxhetit të shtetit (e paraqitur në tabelë), por jo për shpenzimet për aktorët e tjerë.

	Viti 2026	**Viti 2027**	**Viti 2028**	**Viti 2029**	**Viti 2030**	**Viti 2031**	**Viti 2032**	**Viti 2033**	**Viti 2034**	**Viti 2035**
Faktori zbritës	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
Kosto për buxhetin - një herë	0	6,400,000	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi	0	4,757,647	4,858,376	4,462,127	4,568,991	4,679,061	4,792,433	4,909,206	5,529,482	5,653,366

Kosto për bizneset - një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për bizneset - në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera - një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto në total	0	11,157,647	4,858,376	4,462,127	4,568,991	4,679,061	4,792,433	4,909,206	5,029,482	5,153,366
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës	0	10,153,458	4,615,457	3,882,051	3,746,573	3,696,458	3,594,325	3,485,536	3,420,048	3,349,688
Përfitimet për buxhetin – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi	0									
Përfitimet për grupet e tjera – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për biznesin – një herë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet totale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Përfitimi i zbritur= Përfitimi në total x faktori zbritës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	0									
Vlera prezente aktuale e kostos në total	39,943,594									
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total	0									

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Kjo shtojcë nuk mund të plotësohet pasi për opsionin e zgjedhur, për arsye se ligji ka sjellë risi dhe nuk ka analiza për Shqipërinë për përfitimet, në terma monetarë, që mund të vijnë nga zbatimi i tij. Tek kjo tabelë mund të plotësohet vetëm vlera e Kosto aktuale. Duke pasur parasysh që përfitimi aktual nuk mund të llogaritet, atëherë vlera aktuale neto= përfitimi aktual – kosto aktuale, nuk llogaritet dot

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	39,943,594	0	0

MINISTRIA PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE

ADEA PIRDENI

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA